



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0052**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Triangle” Sh.P.K.” kundër Vendimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA” me nr. të prokurimit: "616-23-10869-5-2-1", me 23/04/2024, mori:

### **Vendim**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE ankues, “Triangle” Sh.P.K.” me numër; 2024/052, e datës, 15.01.2024, lidhur me aktivitetin e “Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA” me numër të prokurimit: "616-23-10869-5-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinë.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues, datës 18.12.2023, - Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1. të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues “Triangle” Sh.P.K.” bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 09.10.2023 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA” me nr. të prokurimit: "616-23-10869-5-2-1". Ndërsa me datë 18.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE “N.N.P. Euro Construction”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës : 70,000.00€.

Me 26.12.2023, OE “Triangle” Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 05.01.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 15.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Triangle” Sh.P.K.” me nr. 52/2024 lidhur me aktivitetin “Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit te ujësjellësit, kanalizimit ne nyjat sanitare ne IEAA” me nr. të prokurimit: “616-23-10869-5-2-1”.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Triangle” Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Sqarim Hyrës : “Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës me datën 05.01.2024 ka bere publikimin e Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar dhe ka rekomanduar për kontrate një OE të papërgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së te vendosura ne NJK dhe DT. Neve me datën 26.12.2023 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-se për te ja bere me dije shkeljet te cilat i ka bere AK ne këtë Aktivitet të Prokurimit por AK as qe merret me pretendimet tona por na refuzon kërkesën tone dhe e shpërblen një OE krejtësisht te papërgjegjshëm dhe si argument thotë qe ju si palë e papërgjegjshme nuk mund te argumentoni papërgjegjshmërinë e OE te shpallur fitues. Tani edhe pranë OSHP-së, së pari po e faktojmë përgjegjshmërinë tonë dhe kundërligjshmërinë e AK-se për të na eliminuar neve.

Pretendimi i parë (I): “Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës me datën 18.12.2023 na ka dërguar letrën standarde si tenderues i eliminuar me arsyetimin e cila është bashkangjitur në ankesë. Sqarojmë ne mënyrë te detajuar : Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunës Se Prishtinës me datën 18.12.2023 ka bere publikimin e Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar dhe ka rekomanduar për kontrate një OE te pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT. Se pari po e faktojmë përgjegjshmërinë tone dhe kundërligjshmërinë e AK-se për te na eliminuar neve. Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunës Se Prishtinës me datën 18.12.2023 na ka dërguar letrën standarde si tenderues i eliminuar me arsyetimin të bashkangjitur në ankesë. AK kundërligjshëm na ka eliminuar me këtë arsyetim te pa qëndrueshëm pasi qe për këtë projekt AK i ka ndare 70,000.00€ dhe ky tender është kontrate publike kornize ku sipas pikës 2 te nenit 38 te LPP-se, ne kontratat publike kornize mospërputhja totale e vlerës lejohet deri ne plus minus 30% te vlerës totale. Pra ky eliminim i AK-se është i kundërligjshëm dhe AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 38 te LPP-se. AK ne mënyrë te kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate Operatorin Ekonomik te pa përgjegjshëm i cili nuk

i ka plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.) 1. OE i rekomanduar për kontrate nuk i plotëson te gjitha kërkesat e AK-se dhe ka aplikuar me dokumente te falsifikuara ne këtë tender ku po e cekim si në ankesë. AK ne DT ka kërkuar tek : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, ne vlerë minimale prej 100.000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datë n e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve. Pra siç po shihet nga kërkesa e AK-se operatoret ekonomik qe aplikojnë ne këtë tender për ta plotësuar këtë kërkesë duhet ta plotësojnë Aneksin 6 te dosjes se tenderit ndërsa OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar këtë aneks dhe AK është dashur ta eliminoj pasi qe nuk ju ka përmbajtur kërkesave të AK-së.”

Pretendimi i dytë (II): “AK ne DT ka kërkuar tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 1 .OE duhet te ofroj këtë staf si ne vijim a)Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, Menaxher i projektit - min. 5 vite përvojë pune b) Një inxhinier i ndërtimit i diplomuar apo bachelor - drejtimi hidroteknik min. 5 vite përvojë pune. c) Dy (2) teknik të ndërtimtarisë me 3 vite përvojë pune, te jene te certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Për inxhinieret e kërkuar CV, diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi, ndërsa për 2 tekniket , diploma e shkollës se mesme profesionale , kontratat e punës me punëdhënësin , ose marrëveshje për angazhim ne ketë projekt. OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar këtë kërkesa te AK-se pasi qe OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar Ing i Hidroteknikes z. Faton Gashi I cili nuk i plotëson kriteret e FDT-se pasi qe I njëjti nuk ka dëshmi qe ka udhëhequr projekte te ngjashme ne lëmin e kërkuar sipas CV se prezantuar mbi 90% te prezantimit ne CV e ka projektim, ndërsa ne fund OE i ka bashkëngjitur një letër reference ne te cilën thuhet se ing ne fjalë qe nga viti 2017 dhe ende vazhdon te luaj një rol kyç ne kompaninë EURO Construction një gjë e cila nuk korrespondon me CV e prezantuar nga ana e Ing pasi i njëjti ne CV askund nuk e prezanton qe ka udhëhequr ose punuar ne kompaninë ne fjalë si dëshmi shih pjesën e CV se ing-se. Neve po dyshojmë se ky OE e ka falsifikuar nënshkrimin e ing ne fjale pasi qe ne se i shikojmë nënshkrimet e tije ne CV ne te tete faqet e CV-se janë te njëjtë ndërsa ne Kontrate është i ndryshëm qe kontratën e kane përpiluar vet OE pa praninë e Fatonit dhe e kane nënshkruar vete dikush nga personat e OE-se e jo Fatoni. AK ne DT ka kërkuar tek : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.OE duhet te ofroj këtë staf si ne vijim a)Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, Menaxher i projektit - min. 5 vite përvojë pune b) Një inxhinier i ndërtimit i diplomuar apo bachelor - drejtimi hidroteknik min. 5 vite përvojë pune. c) Dy (2) teknik të ndërtimtarisë me 3 vite përvojë pune, te jene te certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune. Shihet qarte se Fatoni ne te tete faqet e CV-se nuk e ka gabuar dhe nuk ka patur devijime ne nënshkrim tani ne kontrate shihet se krejt dikush tjetër e ka nënshkruar dhe neve dyshojmë se dikush nga stafi i OE te rekomanduar për kontrate e ka nënshkruar andaj kërkojmë nga AK qe ta ekzaminoj këtë nënshkrim. Po ashtu si fakt për te dëshmuar qe kjo letër Referencë nuk është dhe nuk ka te bej qe ai ka punuar ne kompani Euro construction e dëshmon edhe referenca e lëshuar nga kompania ne fjale ku e njëjta ne fund te përshkrimit ne Letër Referencë ju drejtohet te tjerëve me një rekomandim për bashkëpunim me Z. Mehani dhe jo me Z. Gashi. AK është dashur qe ta eliminoj këtë OE pasi qe nuk është kjo kërkesa e vetme qe nuk e

ka plotësuar.

Pretendimi i tretë (III) : “ Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.OE duhet te ofroj këtë staf si ne vijim a)Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, Menaxher i projektit - min. 5 vite përvojë pune b) Një inxhinier i ndërtimit i diplomuar apo bachelor - drejtimi hidroteknik min. 5 vite përvojë pune. c) Dy (2) teknik të ndërtimtarisë me 3 vite përvojë pune, te jene te certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2.Per inxhinieret e kërkuar CV, diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi, ndërsa për 2 tekniket , diploma e shkollës se mesme profesionale , kontratat e punës me punëdhënësin , ose marrëveshje për angazhim ne këtë projekt. AK ka kërkuar qe menaxheri i projektit te ketë minimum 5 vite përvojë pune ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka prezantuar z.Jasmir Morina i cili ka diplomuar me 11 shkurt 2022 dëshminë e keni në ankesë. Pra i njëjti ndoshta ka mundur ti kryej provimet me herët por ka diplomuar me 2022 dhe profesionin si ing i diplomuar e ushtron nga kjo kohe, pra edhe kjo është një arsye tjetër qe OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm dhe AK është dashur që ta eliminoj e jo ta shpërblej me kontratë.

Pretendimi i katërt (IV) : “Është për tu habitur fakti se si OE i rekomanduar ka dhen çmime jo normalisht te ultë për dy pozicione te cilat janë pozicion shume specifike dhe te rëndësishme për ketë kontrate dhe është për tu habitur fakti se si AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë dhe zberthim te kostos financiare për këto dy pozicione. Pozicioni nr. 45 HPL ku OE ka ofruar çmim 105 €/m2 ndërsa çmimi në treg për këtë pozicion është 110 €/m2 është vetëm çmimi i furnizimit. Pozicioni nr. 80 Furnizimi i lavamanëve sipas përshkrimit ne paramasë dhe detalit te dhënë ne foto i cili duhet te punohet sipas standardeve dhe udhëzimeve te OM. Kostoja e ti për furnizim është 300 € copa ndërsa OE ka ofruar një çmim banal prej 60€ për cope, andaj është për tu habitur se si AK nuk e ka kërkuar as një sqarim shtesë. AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 61 te LPP-se pasi qe nuk ka zhvilluar kurrfarë procedure inter-partes për ti sqaruar këto çmime ajo normalisht te ulëta. I bëjmë me dije AK-se se konform Rregullore Nr.001\_2022 për prokurimin publik AK nuk ka mundur te na eliminoj me këtë arsyetim po e sqaroj me poshtë bazën Ligjore; AK është dashur te veproj sipas Rregullore Nr.001\_2022 për prokurimin publik ku sipas nenit 41.6 thuhet: Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zberthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". Siç po shihet me fakte e kemi sqaruar se AK ka rekomanduar një OE të pa përgjegjshëm dhe AK ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore pasi qe këtë OE është dashur ta eliminoj e jo ta shpërblej me kontratë. Neve do ta kërkojmë te drejtën tonë në çdo Organ të Republikës së Kosovës qoftë ato Administrative apo edhe Penale pasi qe po na mohohet e drejta jone ligjore ne mënyrë te kundërligjshëm dhe haptas AK na diskriminon neve dhe e favorizon një OE i cili është i pa përgjegjshëm dhe ka manipuluar me dokumente te tenderit. Shihet qarte se AK ka bere shkelje të nenit 7 të LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Si dhe ne piken 2 thuhet: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. AK për këtë aktivitet te

prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve e ka bërë në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nuk e ka respektuar edhe nenin 41.6 të Rregullore Nr.001\_2022 për prokurimin publik. Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, 6, 7, 59, 60, 61 të LPP-së si dhe AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të Rregulloreve të KRPP-se. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-se që ti konstatoj të gjitha këto shkelje të AK-se ndërsa nga Paneli Shqyrtues i OSHP-se ta detyrojë AK-në që ti respektoj në përpikëri dispozitat e ligjit të prokurimit publik gjithashtu ti respektoj kërkesat e veta të cilat vet i ka vendosur në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe të nxjerr: Vendim që të Apropohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik : Triangle Sh.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA me nr. të prokurimit: 616-23-10869-5-2-1 dhe numër të brendshëm 616-23-192-5-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës. II. Anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA me nr. të prokurimit: 616-23-10869-5-2-1 dhe numër të brendshëm 616-23-192-5-2-1 dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.”

-Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim-

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet cekur se vlera e parashikuar e kontratës në këtë aktivitet të prokurimit është 70,000.00 euro. Ndërsa parashtruesi në këtë tender ka ofertuar me çmimin prej 104,444.00 euro. Në këtë mënyrë parashtruesi ka dorëzuar një çmim i cili në mënyrë të konsiderueshme e tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës. Argumenti që e përdor parashtruesi sipas të cilit të kontratat publike kornizë lejohet tejkalmimi i vlerës indikative deri në plus/ minus 30% është argument i paqëndrueshëm pasi që nuk manifeston interpretimin e saktë të dispozitës që i referohet parashtruesi. Fillimisht duhet cekur se neni 54.10 të RRPP është cekur se "Nëse AK deklaron përqindjen e mospërrputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%)). Pra dispozita në fjalë nuk ka të bëjë me tejkalmimin e vlerës deri në 30% siç pretendon parashtruesi. Një veprim i tillë në fakt është i kundërligjshëm dhe rreptësisht i ndaluar sipas ligjit në fuqi të prokurimit publik. Dispozita në fjalë ka të bëjë me rastet kur pasi që të lidhet kontrata, nëse urdhër blerjet e tejkalojnë vlerën totale indikative, atëherë mund të tejkalojë sasia indikative deri në +30%. Pra kjo situatë juridike është krejt ndryshe prej mënyrës se si e ka interpretuar parashtruesi në pretendimin ankimor. Sidoqoftë, nuk është aspak i kontestueshëm fakti se çmimi me të cilin ka ofertuar parashtruesi është për 32.97% apo 34,444.00 euro më i lartë sesa vlera e parashikuar e kontratës (e cila është 70,000.00 euro). Pra edhe po të ishte i qëndrueshëm juridikisht argumenti i përdorur nga parashtruesi (lidhur me +30%), sërish pretendimi do të ishte kundërrthënës pasi që tejkalmimi i vlerës së kontratës nga parashtruesi është me 32.97% (pra më shumë se 30%). Me fjalë të tjera, nga cilido këndvështrim i mundshëm pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi. Rrjedhimisht oferta e parashtruesit është ofertë e papërgjegjshme ndërsa vendimi i autoritetit kontraktues për eliminimin e parashtruesit nga tenderi është vendim plotësisht i drejtë. Sa i përket pretendimeve

të tjera ankimore të parashtruesit të cilat i referohen ekskluzivisht tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit, është gjetur se parashtruesi duke qenë tenderues i papërgjegjshëm në këtë rast nuk mund të dëshmojë asnjë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht nuk është fare palë e interesuar në raport me këto pretendime të tij. Përmes nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 26 të LPP me termin palë e interesuar nënkuptohet "personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar. Në rastin konkret parashtruesi është tenderues i papërgjegjshëm sikurse është sqaruar edhe më sipër në këtë vendim. Prandaj nga cilindo epilog i mundshëm i këtij aktiviteti të prokurimit, parashtruesi në asnjë formë nuk mund të dëshmojë ndonjë interes material. Prandaj parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me këto pretendime të tij dhe rrjedhimisht pretendimet e tij referuar kundër tenderuesve të tjerë janë të pabazuara. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nën paragrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nën paragrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

*-Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 52/2024, ndërsa me datë 01.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/52 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu edhe OE Nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

*-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE “Triangle” Sh.P.K eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/52 ka vlerësuar si në vijim:*

Sqarim Hyrës: “Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues –Komuna e Prishtinës, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit. Autoriteti Kontaktues –Komuna e Prishtinës, me datën: 15.12.2023, ka publikuar njoftimin B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm OE ankues me datën: 26.12.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim ndërsa AK-ja me datën 04.01.2024 refuzon kërkesën e OE ankues si të pabazuar.”

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Triangle, i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja nuk i ka zbatuar dispozitat e LPP-se, konkretisht me rastin e përfundimit të vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues e ka

njoftuar me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar dhe njëherit OE ankues pretendon se AK-ja, e ka rekomanduar për kontratë një operatore ekonomik të papërgjegjshëm. Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues e ka pranuar letrën standarde të eliminuar përmes të cilës është njoftuar si i papërgjegjshëm me arsyetimin se e ka tejkaluar vlerën e parashikuar të kontratës e cila ka qenë: 70,000.00€, ndërsa vlera e ofertës se OE ankues është: 104,444.00€. Sa i përket arsyes se eliminimit të OE ankues, i cili lidhur me këtë çështje pretendon se është i paqëndrueshëm ky pretendim i autoritetit kontraktues sepse ky tender është kontratë kornizë dhe se sipas dispozitave të pikës 2 të nenit 38 të LPP-së, ne kontratat kornize mospërputhja totale e vlerës lejohet deri ne plus minus 30% të vlerës totale. Pra, sipas OE ankues eliminimi jone nga ky aktivitet i prokurimit, është i kundërligjshëm sepse AK-ja ka vepruar ne kundërshtim me nenin 38 të LPP-se. Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues për shkelje të dispozitave ligjore të nenit 38 të LPP-së, për faktin se OE ankues bën interpretim të gabuar të dispozitave të nenit 38.2 të LPP-së, për faktin se fillimisht duhet të merret parasysh neni 54.10 i Rregullores për prokurim publik. Megjithatë eksperti shqyrtues sqaron se oferta e OE ankues është 49% me lart se vlera e parashikuar e kontratës, që do të thotë se edhe po të aplikohet neni 38.2 i LPP-se ashtu si pretendon OE ankues, atëherë edhe ne këtë rast oferta financiare e OE ankues është me shume se 30% i vlerës se parashikuar të kontratës. Pra, OE ankues ne këtë rast i ka plotësuar kushtet për tu kualifikuar si palë pa interes material të parapare ne nenin 4.1.26 të LPP-së. ”

Konstatimi i dyte (II): “OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar aneën 6 të dosjes se tenderit – listën e kontratave të realizuara. Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se i rekomanduari duhet te shpallet i papërgjegjshëm, sepse OE i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar listën e kontratave e cila është njëjtë me atë të dosjes se tenderit, pra i përmban të gjitha të dhëna e kërkuara nga autoriteti kontraktues.”

Konstatimi i tretë (III): “OE ankues, ne ankesën e tij ka pretendime ankimore në lidhje me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, për te cilin pretendon se e ka falsifikuar nënshkrimin e Inxhinierit të Hidroteknikes, ( F. G) me arsyetimin se ne disa dëshmi të inxhinierit ne fjalë nënshkrimi është i njëjtë ndërsa ne një dëshmi ndryshon. Me qellim të verifikimit të pretendimit të OE ankues, me datën: 26.01.2024 ne cilësinë e ekspertit. shqyrtues i jam drejtuar me shkrim inxhinierit F.G, te cilin e kam njoftuar me dëshmitë për të cilat pretendohet se janë të falsifikuara Në përgjigje të kërkesës Inxhinierit F.G është përgjigjur me datën: 30.01.2024, i cili ka deklaruar se për projektin: Renovimi i Shkollave fillore - renovimi i rrjetit te ujësjellësit, kanalizimit ne nyjet sanitare ne IEAA me numër identifikues: 616-23-10869-5-2-1 deklaroj me përgjegjësi të plotë se jam në marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë NNP EURO CONSTRUCTION (Bislim Morina) B.I. Gjithashtu deklaroj se unë e kam nënshkruar kontratën për bashkëpunim lidhur me këtë projekt dhe i qëndroj prapa nënshkrimit tim. Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimin e Inxhinierit F.G, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues për falsifikim të dokumenteve për faktin se Inxhinieri e ka konfirmuar se për projektin ne fjale është në dijeni dhe se ka bashkëpunim me OE të rekomanduar për kontratë.”

Konstatimi i katërt (IV): “OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e DT-se, lidhur me përvojën e punës për Inxhinierit e Ndërtimtarisë. ( J. M), ku ne dosje te tenderit është kërkuar min. 5 vite përvojë pune dhe se sipas OE ankues Inxhinieri ne fjalë ka diplomuar me 11.02.2022. Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse inxhinieri ne fjalë ka ofruar dëshmi te mjaftueshme se ka diplomuar me datën: 02 Qershor 2008. Fakti qe ne diplomën e re ne të cilën ka pasur qasje OE ankues, është shënuar data: 11.Shkurt 2022, është bere për arsye se ne diplomën e lëshuar me datën: 02.Qershor.2008 nuk i është shënuar drejtimi konstruktiv por është shënuar vetëm dega

ndërtimtari dhe me qëllim të korigjimit të këtij lëshimi me kërkesë të vet inxhinierit është bere kërkesa pran universitetit dhe pas korigjimit i është lëshuar diploma e re ne te cilën figuron data e lëshimit 11.02.2022, ndërsa data e diplomimit është 02.Qershor.2008. Prandaj, pretendimi i OE ankues është i paqëndrueshëm. Diploma e parë dhe diploma e dytë janë të bashkangjitur ne ekspertizë.”

Konstatimi i pestë (V): “Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, gjithashtu pretendon se i rekomanduari për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht te ulëta, ne disa pozicione (pozicioni 54 dhe 80), duke mos i respektuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe të rregullores për çmime Jo/Normalisht te ulëta. Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, për mos respektim te dispozitave te nenit 61 të LPP-së, për faktin se sipas dispozitave te nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i çmimit është e drejtë e autoritetit kontraktues. Vlen te përmendet fakti se vlera totale e ofertës se OE te rekomanduar për kontrate është 69,940.50€, pra shume afër vlerës se parashikuar te kontratës (vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00€).”

*-Gjetjet e Panelit shqyrtues-*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë Raportit të ekspertit shqyrtues, me rastin e vlerësimit të pretendimeve ankimore të OE ankues “Triangle” Sh.P.K.”.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se vlerësimet sipas raportit të ekspertit shqyrtues janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues e mbështet Raportin me rekomandime, me rastin e vendosjes te ankesës së OE ankues “Triangle” Sh.P.K.”. Rrjedhimisht Paneli



shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e eksperteve, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku ka shpërblyer me kontratë OE "N.N.P. Euro Construction", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit te ujësjellësit, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA" me numër të prokurimit: "616-23-10869-5-2-1".

Paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e Raportit të ekspertit shqyrtues dhe dokumentet e Dosjes se tenderit, konsideron se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se ka pasur shkelje të procedurave ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues, gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit te ujësjellësit, kanalizimit ne nyjat sanitare ne IEAA" me nr. të prokurimit: "616-23-10869-5-2-1", AK- Komuna e Prishtinës.

Paneli shqyrtues konstaton se oferta e OE ankues është me lart se vlera e parashikuar e kontratës, që do të thotë se edhe po të aplikohet neni 38.2 i LPP-se ashtu si pretendon OE ankues, atëherë edhe në këtë rast oferta financiare e OE ankues është me shume se 30% i vlerës se parashikuar të kontratës, andaj OE ankues në këtë rast me të drejte është kualifikuar nga Autoriteti kontraktues si palë pa interes material të parapare në nenin 4.1.26 të LPP-së.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE "Triangle" Sh.P.K.", vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "TRIANGLE" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: